



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2018:008307

Datë: 22.03.2018

Numri i dokumentit: 00017176

**P.nr.1005/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL** Sipas gjyqtarit Ramiz Azizi, me pjesëmarrjen e zyrtaren ligjore Florentina Ademi në lëndën penale kundër të pandehurit F.Z. nga ..., me numër personal ..., për shkak të veprës penale posedim i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga Neni 275 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Gjilan - Departamenti i përgjithshëm nr. PP.II.1679/2017 , të datës 22.09.2017 në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 21.03.2018 në praninë e Prokurorit të Shtetit Leonora Shemsiu Kadriu të pandehurit F.Z., më datë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 21.03.2018 përpiloi, këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri F.Z., nga babai S. dhe nëna K. e lindur B., i lindur më data e lindjes..., në ..., ku edhe jeton në rrugën “ ... ” nr. ... i martuar, e ka të kryer shkollen e mesme, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Është Fajtor**

**SEPSE**

Më datë 23.08.2017, rreth orës 14:00, në Qendrën e Paraburgimit në fsh. ... K. ..., i pandehuri ka poseduar pa autorizim substanca narkotike të llojit “ ... ”, në peshë prej 0.3 gram, në dhomën ku qëndronte i njëjti, të cilën e kshihte fshehur në mbathje të tij – në papuçe, të cilin e ka sjellë në këtë Qendër të Paraburgimit, pasi paraprakisht ishte kthyer nga vikendi.

**- me çka ka kryer veprë penale posedim i pa autorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 2 i KPRK-së.**

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,21,49,50,51,52, ,69 e 73 të KPRK, si dhe nenit 365 e 451 të KPP, të pandehurit i shqipton :

## DËNIM ME KUSHT

Të pandehurit **F.Z.** i shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej **150 (njëqind e pesëdhjetë) ditëve**, të cilin dënim i pandehuri nuk do ta mbajë nëse në afat prej **1 (një) viti** nuk kryen vepër tjetër penale.

Po ashtu atij do ti shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i substancës se gjetur narkotike.

Obligohet i pandehuri që t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 20 €, në emër të paushallit gjyqësor, si dhe shpenzimet e tjera të procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj Gjykate, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

## Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën e lartcekur ndaj të F.Z., për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 parag.2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor të datës 20.03.2018, pas leximit të aktakuzës, i pandehuri F.Z., ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar e pranojë fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale e cila më vihet në barrë sipas kësaj aktakuze.

Gjykata, pas dëgjimit edhe të Prokurorit të Shtetit dhe të konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, ngase i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri; pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i pandehuri F.Z. ka kryer veprën penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 275 parag.2 lidhur me paragrafin 1. të KPRK-së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjyqtari i vetëm gjykues, e shpalli fajtor të pandehurin F.Z., nga ., për shkak të veprës penale, posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope apo analoge nga neni 275 par.2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njejtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njejtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit F.Z., gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KPRK, ku si rrethana lehtësuese, gjykata e ka marrë për bazë faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, sjelljen e mirë gjatë shqyrtimit fillestar. Ndërsa, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë rënduese, pos gjetjes së substancës narkotike të i njëjti.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, caktimi i dënimit të kushtëzuar me burgim ndaj të pandehurit F.Z., është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 50 të KPRK-së.

Vendimi mbi dënimin plotësues është i bazuar në nenin 62 e 69 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 451 paragrafi 1 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2018:008307, 21.03.2018**

**G j y q t a r i**

---

Ramiz Azizi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2018:008307  
Datë: 22.03.2018  
Numri i dokumentit: 00017176